



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT 27 JAN 2023
14-020/04-20569/22, më _____


Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008) dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për lëshimin e certifikatës së përdorimit për objektet ndërtimore.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është në këtë përbërje:
 1. Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, kryesues;
 2. Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, anëtar;
 3. Vilaznim Osmani, shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar;
 4. Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës;
 5. Donika Cetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve dhe Hapësirave Publike.
3. Detyrë e komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, është shqyrtimi i kërkesave për lëshimin e certifikatës së përdorimit nga poseduesit e lejes ndërtimore dhe vendosja konform Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën e lëshimit të certifikatës së përdorimit.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama